



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	11.10.2024
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan z. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës – Muaji Shtator 02.09.2024-30.09.2024

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë muajit Shtator DKA ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme brenda kompetencave të veta.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë muajit shtator, është bërë përgaditja e formularëve për ndryshime të personelit shkollor.

Është bërë DDD në qerdhen Amë dhe paralelet, në Gadime, Sllovi, Shalë dhe Rufc i Ri

Gjatë muajit Shtator janë kryer këto punë:

- Nënalokimi i mjeteve në të gjitha kategoritë dhe nivelet
- Zotimi i mjeteve në të gjitha kategoritë dhe nivelet
- Futja e buxhetit në BDMS
- Hartimi, planifikimi dhe implementimi i buxhetit për vitin në programin BDMS.

Është shënuar Dita e shkollës me datë 14.09.2024 në shkollën “Adem Gllavica” në Lipjan, dhe në Bujan në shkollën “Nezë Bujani”, me datë 20.09.2024.

Është mbajtur takimi i komisionit për vlerësimin e nënësëve me nevoja të veqanta, ku është diskutuar për vizitat nëpër shkolla për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veqanta.

Gjithashtu komisioni për vlerësimin e nxënësve kanë mbajtur takimet me nxënës dhe prindër në shkollën Vëllezërit Frashëri dhe në shkollën Ismail Luma Lipjan, me ç’rast janë vlerësuar 17 nxënës të rekomanduar nga shkollat.

Është mbajtur takimi i komisionit për Draft-Rregulloren për organizimin e punës së institucioneve edukative-arsimore të komunës së Lipjanit, ku e njejtja ka kaluar ne diskutim publik dhe është proceduar për në kuvend.

Zyrtarja për buxhet ka ndjekur trajnimin në Ministrinë e Financave për tu çertifikuar, e cila është caktuar me vendim si zyrtare zotuese në DKA.

Ka përfunduar Renovimi i shkollës “Migjeni” në Rufe I Ri.

Kanë përfunduar Renovimet e banjove në shkollat:

Ismail Luma në Lipjan, dhe

“Katër Dëshmoret” në Krojmir

Në shfmu Llugaxhi është intervenuar në shkollë në krijimin e hapësirave të reja mësimore në mënyrë që shkolla të kaloj me punë në një ndërrim.

Ndërsa në tabelën si më poshtë,gjeni të bashkangjitur rezultatet e Testit të Maturës shtetërore, afati i gushtit 2024

GJIMNAZI"ULPIANA"LIPJAN

DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHSEJ NXËNËS
Gjimnazi	75		58		133
GJITHSEJ	75		58		133

SHMP"ADEM GLLAVICA"LIPJAN

DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHSEJ NXËNËS
EKONOMI	19		21		40
ADMINISTRATË	19		25		44
KIMI-TEKNOLOGJI	5		9		14
BUJQËSI	1		3		4
ELEKTROTEKNIKË	11		11		22
MAKINERI	3		2		5
NDËRTIMTARI	12		7		19
GJITHSEJ	70	47.30	78	52.70	148
SHML"SHAQIR HOXHA" SHALË					
DREJTIMI	POZITIV	%	NEGATIV	%	GJITHSEJ NXËNËS
NATYROR	3		9		11
SHOQËROR-GJUHËSOR	5		7		12
EKON:BANKA DHE FINANCA	0		2		2
GJITHSEJ	8	32.00	18	72.00	25

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:

- Formular për ndryshime-kthimi nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit, shtimi i përvojës,
- Formular për largim-skadim kontrate, pensionimi,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme-ndërrimi i xhirollogarisë.

Nënalokimi i mjeteve në të gjitha kategoritë:

- a). Paga&meditje
- b). Mallra&komunali
- c). Komunali

Zotimet në kategorinë mallra & shërbime dhe komunali.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme (kërkesa për punësim, pushim mjekësor, pushim lehonie etj).

REKOMANDIMET

- Angazhimi i drejtorëve të shkollave për një organizim sa më të mirë të procesit edukativo-arsimor dhe
- Angazhimi i psikologeve në trajtimin e temave me rëndësi për nxënësit në të gjitha shkollat e Komunës.

ÇËSHTJE TJERA

Të gjitha punët e realizuara janë cekur në raport dhe nuk ka ndonjë çështje tjetër për të elaboruar. DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.